

	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	1 / 20

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Kjo rregullore përcakton rregullat institucionale për parandalimin, identifikimin, raportimin, verifikimin dhe trajtimin e plagjiaturës dhe të shkeljeve të tjera të integritetit akademik në Universitetin Western Balkans, në vijim WBU.
2. Rregullorja synon të mbrojë ndershmërinë akademike, besueshmërinë e vlerësimit, cilësinë e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, të drejtat e autorit, si dhe vlefshmërinë e diplomave, gradave dhe titujve akademikë.
3. Kjo rregullore zbatohet në bashkërendim me Statutin e WBU-së, Rregulloren për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor, Procedurën për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës dhe aktet e tjera të brendshme. Në rast mospërputhjeje zbatohet akti me fuqi më të lartë; ndërmjet akteve të së njëjtës fuqi zbatohet dispozita e posaçme, për atë që nuk cenon garancitë procedurale dhe kompetencat e përcaktuara në Statut.

Neni 2


Baza ligjore dhe dokumentet orientuese

Kjo rregullore mbështetet në:

- a) ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- b) ligjin nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë";
- c) legjislationin në fuqi për procedurat administrative, marrëdhëniet e punës, të drejtën e autorit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në masën e zbatueshme;
- d) VKM nr. 777, datë 26.12.2018, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore", të ndryshuar me VKM nr. 99, datë 5.2.2020;
- e) VKM nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë", të ndryshuar;
- f) VKM nr. 831, datë 30.12.2025, "Për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor";
- g) Statutin e WBU-së, Rregulloren për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor, Procedurën për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Etikës, Rregulloren e Diplomimit dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës.

2. Për interpretimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje merren në konsideratë Kodi Evropian i Sjelljes për Integritetin në Kërkim i ALLEA-s, udhëzimet e ENACT dhe COPE-s, si dhe

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	2 / 20

rekomandimet e organeve kombëtare të sigurimit të cilësisë. Dokumentet orientuese nuk zëvendësojnë kuadrin ligjor detyrues.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për studentët e të gjitha cikleve, personelin akademik dhe ndihmësakademik, punonjësit kërkimorë-shkencorë, personelin administrativ kur merr pjesë në veprimtari akademike ose kërkimore, si dhe bashkëpunëtorët e jashtëm në veprimtaritë e organizuara, financuara ose publikuara nga WBU-ja.
2. Ajo zbatohet për detyrat dhe projektet mësimore, punimet e diplomës, disertacionet, botimet dhe komunikimet shkencore, materialet mësimore, aplikimet për financim, raportet kërkimore dhe produkte të tjera akademike ose shkencore, në formë të shkruar, digjitale, vizuale, audiovizive ose të koduar.

Neni 4

Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e përcaktuara në këtë nen. Përkufizimet e plagjiaturës, fabrikimit dhe falsifikimit bazohen në nenin 19, pika 4, të Kodit të Etikës në Shkencë dhe Kërkim Shkencor, miratuar me VKM nr. 831, datë 30.12.2025. Termat e tjerë, kur nuk janë përkufizuar shprehimisht nga legjislacioni në fuqi, përbëjnë përkufizime institucionale dhe interpretohen në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet evropiane të integritetit në kërkim.
2. Në kuptim të kësaj rregulloreje:
 - a) “Plagjiaturë” është përdorimi i punës ose ideve të dikujt tjetër, pa dhënë asnjë meritë të burimi origjinal.
 - b) “Vetëplagjiaturë” është ripërdorimi i konsiderueshëm i një pune të mëparshme personale pa transparencë dhe pa referencë, kur puna paraqitet si kontribut i ri dhe i pavarur.
 - c) “Fabrikim” është manipulimi ose krijimi i të dhënave apo rezultateve dhe regjistrimi ose publikimi i tyre si të vërteta.
 - d) “Falsifikim” është manipulimi i materialeve kërkimore, pajisjeve, imazheve ose proceseve apo ndryshimi, fshirja a retushimi i të dhënave ose rezultateve pa asnjë motiv.
 - e) “Mashttrim akademik” është çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm që synon një përfitim akademik të padrejtë, përfshirë dorëzimin, blerjen ose porositjen e punës së një personi tjetër si punë personale.
 - f) “Sistem antiplagjiaturë” është platforma elektronike e miratuar nga WBU-ja për identifikimin e ngjashmërive tekstuale. Emri tregtar i sistemit dhe konfigurimet teknike përcaktohen me akt administrativ të institucionit dhe nuk kushtëzojnë zbatimin e kësaj rregulloreje.
 - g) “Raport ngjashmërie” është raporti teknik i gjeneruar nga sistemi antiplagjiaturë. Ai është mjet ndihmës dhe nuk provon ose përjashton vetvetiu plagjiaturën.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	3 / 20

- h) “Mjet i inteligjencës artificiale gjeneruese” është çdo sistem që, mbi bazën e kërkesave të përdoruesit, gjeneron ose transformon tekst, kod, imazh, të dhëna, analizë ose përmbajtje tjetër.
- i) “Kontribut thelbësor” është pjesa e punimit që mbart idenë, hipotezën, metodën origjinale, të dhënat, analizën, gjetjet ose përfundimet vendimtare për vlerën akademike të tij.
- j) “Këshilli i Etikës” është organi kolegjal i pavarur i përcaktuar në nenet 30–32 të Statutit të WBU-së. Për qëllimet e zbatimit të VKM nr. 831, datë 30.12.2025, ai ushtron funksionet që Kodi i Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor ia njuh Komitetit të Etikës.

Neni 5

Parimet

Zbatimi i kësaj rregulloreje mbështetet në edukimin dhe parandalimin; vlerësimin cilësor mbi treguesit automatikë; ligjshmërinë dhe proporcionalitetin; prezumimin e pafajësisë; procesin e rregullt, paanshmërinë dhe të drejtën për t’u dëgjuar; shmangien e konfliktit të interesit; konfidencialitetin; mbrojtjen e raportuesit nga hakmarrja; minimizimin e të dhënave personale; gjurmueshmërinë dhe arsyetimin e vendimeve.

KREU II

PARANDALIMI DHE PËRDORIMI I MJETEVE TEKNOLOGJIKE

Neni 6

Edukimi dhe përgjegjësitë institucionale

- WBU-ja organizon informim dhe trajnim periodik për citimin, autorësinë, menaxhimin e të dhënave, përdorimin e përgjegjshëm të inteligjencës artificiale dhe interpretimin e raporteve të ngjashmërisë.
- Njësitë akademike sigurojnë që studentët të njihen me kërkesat e integritetit që në fillim të programit dhe, sipas rastit, në përshkrimin e lëndës ose të detyrës.
- Personeli akademik përcakton qartë format e bashkëpunimit, përdorimit të burimeve dhe të mjeteve digjitale që lejohen në çdo detyrë.

Neni 7

Punimet që i nënshtrohen kontrollit

- Kontrollit të detyrueshëm me sistemin antiplagjiaturë i nënshtrohen punimet e diplomës, disertacionet e doktoratës, botimet institucionale dhe çdo kategori tjetër e përcaktuar me vendim të Senatit Akademik.
- Detyrat, esetë, punimet seminarike dhe projektet e lëndëve kontrollohen kur kjo parashikohet në dokumentacionin e lëndës, kërkohet nga pedagogu ose vendoset nga njësia bazë.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	4 / 20

- Për botimet dhe veprimtaritë shkencore, autori dorëzon materialin sipas procedurës së përcaktuar nga njësia organizuese. Përgjegjësi i botimit ose veprimtarisë verifikon që kontrolli është kryer dhe administron vetëm dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 8

Interpretimi i raportit të ngjashmërisë

- Raporti shqyrtohet nga një person me kompetencë akademike në fushën përkatëse, duke analizuar burimet e përputhjes, citimet, bibliografinë, formulimet standarde, tekstet normative, terminologjinë disiplinore dhe rëndësinë e pjesës së përputhur.
- Përqindja e ngjashmërisë nuk përdoret si provë e vetme për masë akademike ose disiplinore. Një përqindje e ulët nuk përjashton plagjiaturën e një kontributi thelbësor, ndërsa një përqindje e lartë nuk provon shkelje kur përputhjet janë të ligjshme dhe të referuara.
- Përpara gjenerimit të raportit përfundimtar zbatohen përjashtimet teknike të miratuara nga WBU-ja, si bibliografia, citimet e drejtpërdrejta dhe përputhjet e shkurtra, kur kjo është e përshtatshme për disipinën.

Neni 9

Përdorimi i inteligjencës artificiale


- Përdorimi i mjeteve të inteligjencës artificiale lejohet në masën e përcaktuar nga kërkesat e detyrës, programit, udhëheqësit akademik, politikës së botimit ose projektit kërkimor.
- Pa cenuar rregullat e posaçme, IA-ja mund të përdoret për mbështetje gjuhësore, kërkim paraprak, organizim, përmbledhje, klasifikim ose vizualizim të të dhënave, ideim, kodim ndihmës dhe funksione të ngjashme, me kusht që autori të verifikojë saktësinë, burimet, ligjshmërinë dhe të ruajë përgjegjësinë intelektuale për produktin.
- Ndalohet paraqitja si kontribut personal e një përmbajtjeje thelbësore të prodhuar nga IA-ja, fabrikimi i burimeve ose i të dhënave, si dhe përpunimi në një mjet IA i të dhënave personale, konfidenciale ose të mbrojtura pa bazë ligjore dhe autorizim.
- IA-ja nuk njihet si autor ose bashkautor. Përdorimi material i saj deklarohet sipas aneksit 1, duke treguar mjetin, qëllimin, pjesën ku është përdorur dhe mënyrën e verifikimit nga autori.
- Mungesa e deklarimit vlerësohet sipas natyrës, shtrirjes, qëllimshmërisë dhe ndikimit të përdorimit; ajo nuk barazohet automatikisht me plagjiaturën.

Neni 10

Raportet automatike për përmbajtjen e gjeneruar nga IA

- Mjetet automatike për identifikimin e përmbajtjes së gjeneruar nga inteligjenca artificiale përdoren vetëm kur ofruesi i sistemit konfirmon zyrtarisht se sistemi është i përshtatshëm për gjuhën, formatin dhe llojin e përmbajtjes që kontrollohet.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	5 / 20

2. Për rezultatet e prodhuara nga mjetet e zbulimit të IA-së nuk përcaktohet një prag përqindjeje, mbi bazën e të cilit punimi pranohet ose refuzohet automatikisht. Kjo dispozitë nuk zbatohet për indeksin e ngjashmërisë tekstuale të parashikuar në nenin 11.
3. Rezultati i prodhuar nga mjeti i zbulimit të IA-së shërben vetëm si tregues paraprak dhe nuk provon, në vetvete, përdorimin e inteligjencës artificiale. Ai nuk mund të përdoret si bazë e vetme për refuzimin e punimit, uljen e vlerësimit ose marrjen e një mase akademike apo disiplinore.
4. Kur rezultati, i shqyrtuar së bashku me elemente të tjera, krijon një dyshim të arsyeshëm, autori ftohet të shpjegojë procesin e përgatitjes së punimit dhe mund të paraqesë versione të mëparshme, shënime, burime, të dhëna, historikun e redaktimit ose prova të tjera. Vlerësimi përfundimtar kryhet nga personi ose organi akademik kompetent, në mënyrë të arsyetuar.

KREU III


KONTROLLI I PUNIMEVE TË DIPLOMËS DHE DOKTORATËS

Neni 11

Kushtet e kontrollit përpara mbrojtjes

1. Çdo punim diplome dhe disertacion i nënshtrohet kontrollit të ngjashmërisë tekstuale përpara kalimit në procedurën e vlerësimit ose të mbrojtjes.
2. Për punimet e diplomës, indeksi i ngjashmërisë tekstuale deri në 25%, pas zbatimit të përjashtimeve teknike, përdoret si tregues orientues për kalimin administrativ në fazën e vlerësimit. Ky indeks nuk përbën, në vetvete, provë të plagjiaturës dhe nuk përjashton verifikimin akademik të punimit.
3. Tejkalimi i indeksit orientues prej 25% nuk sjell automatikisht refuzimin ose kthimin e punimit. Udhëheqësi akademik shqyrton burimet dhe natyrën e përpunimeve dhe, me vlerësim të arsyetuar:
 - a) rekomandon kalimin e punimit në fazën e vlerësimit, kur përpunimet janë të ligjshme, të cituara ose lidhen me formulime standarde;
 - b) kërkon rishikimin e punimit, kur përpunimet evidentojnë mangësi në citim ose në paraqitjen e kontributit personal; ose
 - c) referon çështjen sipas procedurës së parashikuar në këtë rregullore, kur ekzistojnë indicie të arsyeshme për plagjiaturë.
4. Një indeks ngjashmërie nën 25% nuk përjashton verifikimin e mëtejshëm, kur dyshohet për përvetësimin e një ideje, rezultati ose kontributi thelbësor.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	6 / 20

5. Për disertacionet zbatohen kërkesat e legjislacionit të posaçëm, Rregullores së Studimeve të Doktoratës dhe vendimeve të organeve kompetente.

Neni 12

Dokumentacioni i dosjes

Dosja përmban raportin përfundimtar të ngjashmërisë, vlerësimin e udhëheqësit ose personit përgjegjës, deklaratën e autorësisë, deklaratën për përdorimin e IA-së kur është e zbatueshme, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara nga Rregullorja e Diplomimit ose rregullorja e doktoratës.

Neni 13

Dyshimi gjatë procedurës së diplomimit dhe doktoratës

- Kur gjatë procedurës së diplomimit ose doktoratës lind një dyshim i bazuar për plagjiaturë ose shkelje tjetër të integritetit, procedura përkatëse pezullohet me akt të arsyetuar dhe çështja i referohet Këshillit të Etikës. Pezullimi vendoset me akt të arsyetuar nga organi që administron procedurën akademike përkatëse, sipas Rregullores së Diplomimit ose Rregullores së Studimeve të Doktoratës. Raporti teknik, i vetëm, nuk përbën bazë të mjaftueshme për fillimin e procedurës disiplinore.
- Tejkalimi i pragut të nenit 11, pa tregues të tjerë, sjell rishikimin e punimit dhe jo fillimin automatik të procedurës disiplinore.
- Pas përfundimit të procedurës etike, procedura akademike vijon sipas Rregullores së Diplomimit ose Rregullores së Studimeve të Doktoratës. Komisioni i Vlerësimit, juria ose Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" vendos vetëm për pasojën akademike brenda kompetencës së vet, ndërsa organi disiplinor vendos për masën disiplinore. Vendimet arsyetohen dhe ankimohen veçmas.

KREU IV

RAPORTIMI DHE PROCEDURA E VERIFIKIMIT

Neni 14

E drejta e raportimit dhe iniciimi kryesisht

- Çdo person mund t'i paraqesë Këshillit të Etikës një raportim për një shkelje të dyshuar të integritetit akademik. Raportuesi duhet të identifikohet nëpërmjet të dhënave të nevojshme për verifikimin e identitetit dhe komunikimin gjatë procedurës.
- Pranueshmëria dhe shqyrtimi i raportimit vlerësohen në bazë të konkretësisë, besueshmërisë dhe mundësisë së verifikimit të informacionit, pavarësisht nëse raportuesi ka ose jo interes personal në çështje.
- Raportimi paraqitet nëpërmjet kanalit institucional të përcaktuar nga Universiteti dhe duhet të përmbajë, për aq sa është e mundur:

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	7 / 20

- identifikimin e punimit ose veprimtarisë akademike të kundërshtuar;
 - përshkrimin e shkeljes së pretenduar;
 - identifikimin e pjesëve konkrete të kundërshtuara;
 - burimin ose burimet me të cilat pretendohet përputhja;
 - dokumentet, materialet ose provat e tjera mbështetëse.
- Kërkesa formale për shqyrtim duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të kërkuarit dhe elementet e tjera të parashikuara në nenin 31 të Statutit. Personat që mund të paraqesin kërkesën formale përcaktohen sipas Statutit dhe akteve të tjera të brendshme të Universitetit.
 - Raportimi që nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e raportuesit nuk pranohet si kërkesë formale dhe nuk krijon për raportuesin të drejta procedurale në kuadër të shqyrtimit.
 - Këshilli i Etikës mund ta fillojë procedurën kryesisht kur, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij ose nga një burim i ligjshëm, merr dijeni për fakte ose prova të besueshme që tregojnë mundësinë e një shkeljeje të integritetit akademik. Fillimi kryesisht bëhet me vendim të arsyetuar dhe mbështetet në verifikimin paraprak të fakteve, jo vetëm në pretendimin e paraqitur.
 - Procedura mund të fillojë pavarësisht nëse çështja lidhet me një proces vlerësimi, diplomimi, promovimi akademik ose me një procedurë tjetër institucionale, duke respektuar kompetencat, afatet dhe kufizimet e përcaktuara nga legjislacioni dhe aktet e brendshme në fuqi.
 - Informacioni fillestar nuk përbën, në vetvete, provë të shkeljes dhe nuk mund të shërbejë si bazë e vetme për konstatimin e përgjegjësisë ose marrjen e një mase akademike apo disiplinore. Faktet duhet të verifikohen në mënyrë të pavarur. Personit ndaj të cilit zhvillohet procedura i garantohet e drejta për t'u informuar, për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur shpjegime dhe prova.
 - Identiteti dhe të dhënat personale të raportuesit trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe u bëhen të ditura vetëm personave që duhet t'i njohin për shkak të detyrës dhe për nevoja të procedurës. Konfidencialiteti zbatohet pa cenuar të drejtën e personit të raportuar për proces të rregullt dhe mbrojtje efektive.
 - Raportuesi që vepron me mirëbesim mbrohet nga çdo formë hakmarrjeje, presioni ose trajtimi të pafavorshëm të lidhur me raportimin. Kjo mbrojtje zbatohet edhe kur shkelja e raportuar nuk vërtetohet, me kusht që raportuesi të ketë pasur arsye të bazuara për të besuar se informacioni ishte i vërtetë në momentin e raportimit.

Neni 15

Regjistrimi dhe shqyrtimi paraprak

- Sekretaria teknike e Këshillit të Etikës regjistron raportimin, konfirmon marrjen dhe ia përcjell Kryetarit pa vonesë.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	8 / 20

- Brenda 10 ditëve pune, Këshilli verifikon kompetencën, identifikueshmërinë e çështjes, ekzistencën e një baze minimale faktike dhe nevojën për masa të përkohshme të ruajtjes së provave.
- Këshilli vendos me arsyetim: a) fillimin e shqyrtimit; b) kërkimin e plotësimeve; c) përcjelljen organit kompetent; ose ç) mosfillimin kur pretendimi është haptazi i pabazuar, jashtë kompetencës ose i pamundur për t'u verifikuar.
- Vendimi për mosfillim i njoftohet raportuesit. Ai mund të kërkojë rishqyrtim pranë Këshillit brenda 10 ditëve pune, duke paraqitur fakte ose prova të reja.

Neni 16

Përbërja e trupit shqyrtues dhe ekspertiza

- Çështja shqyrtohet nga Këshilli i Etikës, me përbërjen dhe rregullat e vendimmarrjes të përcaktuara në nenet 30–32 të Statutit dhe në Rregulloren e Këshillit të Etikës. Kur nevojitet ekspertizë e posaçme, Këshilli cakton një grup ekspertësh ad hoc prej të paktën tre personash. Ekspertët kanë rol këshillimor, nuk marrin pjesë në votim dhe raporti i tyre nuk zëvendëson vendimmarrjen e Këshillit.
- Të paktën një ekspert i jashtëm përfshihet kur çështja lidhet me një drejtues të lartë, anëtar të Këshillit të Etikës, një fushë që nuk mbulohet nga anëtarët ose kur kjo nevojitet për paanshmërinë.
- Anëtarët dhe ekspertët deklarojnë konfliktin e interesit dhe përjashtohen kur paanshmëria e tyre mund të vihet në dyshim. Përjashtimi dhe zëvendësimi dokumentohen.

Neni 17

Të drejtat e personit të përfshirë

Personi ndaj të cilit zhvillohet shqyrtimi ka të drejtë të njoftohet me shkrim për pretendimet; të njihet me provat, me përjashtim të kufizimeve të ligjshme; të ketë kohë të arsyeshme jo më pak se 10 ditë pune për përgjigje; të dëgjohet; të përfaqësohet; të paraqesë prova dhe ekspert; të kërkojë përjashtimin për konflikt interesi; të marrë vendimin e arsyetuar dhe të ushtrojë të drejtën e ankimit. Ai nuk detyrohet të bëjë deklaratime vetëinkriminuese.

Neni 18

Administrimi i provave

- Këshilli administron versionin e punimit, burimet origjinale, raportet teknike, deklaratat, komunikimet dhe çdo provë tjetër relevante e të marrë ligjërisht.
- Analiza identifikon konkretisht pjesët e përputhura, mënyrën e përdorimit, atribuimin, rëndësinë në punim, shtrirjen, qëllimshmërinë ose pakujdesinë dhe ndikimin akademik.
- Raportet e ngjashmërisë dhe të IA-së vlerësohen si indicie teknike dhe gjithmonë së bashku me prova të tjera.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	9 / 20

Neni 19

Afatet

- Shqyrtimi fillestar i raportimit realizohet brenda 30 ditëve nga marrja e tij, në përputhje me nenin 24 të VKM nr. 831, datë 30.12.2025, "Për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkimin Shkencor" dhe nenin 21 të Rregullores për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe në Kërkimin Shkencor të WBU-së. Brenda këtij afati përfshihet shqyrtimi paraprak i parashikuar në nenin 15 të kësaj rregulloreje.
- Pas fazës fillestare, procedura vijon dhe përfundon brenda afateve të legjislacionit për procedurat administrative dhe të akteve të posaçme. Çdo zgjatje duhet të jetë e nevojshme, proporcionale, e arsyetuar dhe t'u njoftohet palëve përpara përfundimit të afatit përkatës.
- Afatet pezullohen vetëm në rastet dhe për kohën e lejuar nga legjislacioni në fuqi, përfshirë sigurimin e ekspertizës ose të dokumentacionit që nuk varet nga WBU-ja. Shkaku, data e fillimit dhe përfundimit të pezullimit dokumentohen dhe u njoftohen palëve.

Neni 20

Raporti i Këshillit të Etikës


- Këshilli miraton raport të arsyetuar që përmban faktet, provat, analizën, përgjigjet ndaj kundërshtimeve, konstatimin nëse ka shkelje, klasifikimin dhe rekomandimin për masën ose veprimin korrigjues.
- Në përputhje me nenin 30 të Statutit, Këshilli administron provat, zhvillon seancat dëgjimore dhe harton raportin me gjetjet dhe rekomandimin për masën. Këshilli nuk vendos masën përfundimtare disiplinore.
- Raporti i përcillet organit kompetent sipas nenit 21 dhe u komunikohet palëve në pjesën që i takon, duke respektuar të drejtat e të tjerëve dhe konfidencialitetin.

Neni 21

Organi kompetent për vendimin përfundimtar

- Në përputhje me nenin 30 të Statutit të WBU-së, raporti dhe rekomandimi i Këshillit i paraqiten organit kompetent si vijon:
 - Rektorit, për marrjen e masave disiplinore ndaj personelit akademik, personelit ndihmës akademik dhe studentëve, brenda kompetencave të përcaktuara në Statut dhe aktet e posaçme të WBU-së;
 - Administratorit, për personelin administrativ;
 - Bordit të Administrimit, kur propozohet largimi nga puna, mbi bazën e raportit të Këshillit dhe të propozimit të organit statutor kompetent, si dhe kur personi nën shqyrtim është Rektori;
 - Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", kur raporti prek vlefshmërinë e një grade të dhënë nga WBU-ja;

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	10 / 20

- e) Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik ose institucionit që ka dhënë titullin, kur raporti prek vlefshmërinë e një titulli akademik.
2. Organi kompetent merr vendim të arsyetuar brenda 20 ditëve pune nga marrja e raportit, duke respektuar kompetencat statutorë. Kur shqyrtohet një masë më e rëndë se ajo e rekomanduar, personit i komunikohet paraprakisht mundësia e kësaj mase dhe i jepet e drejta të paraqesë qëndrimin e tij.
3. Kur çështja lidhet me një anëtar të organit vendimmarrës, ai nuk merr pjesë në shqyrtim, votim ose nënshkrim. Për Rektorin, kompetencat procedurale që normalisht ushtrohen prej tij kalojnë te organi ose autoriteti zëvendësues sipas Statutit.

Neni 22

Kundërshtimi dhe ankimi

- Raporti përfundimtar i Këshillit të Etikës, së bashku me gjetjet dhe rekomandimet e tij, i komunikohet personit të përfshirë përpara marrjes së vendimit përfundimtar, për aq sa nuk cenohen konfidencialiteti, të drejtat e personave të tretë ose një interes tjetër i mbrojtur me ligj.
- Brenda 10 ditëve pune nga komunikimi i raportit, personi i përfshirë mund t'i paraqesë organit kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar kundërshtime me shkrim, shpjegime dhe prova shtesë. Organi kompetent i shqyrton dhe u jep përgjigje të arsyetuar në vendimin përfundimtar.
- Kundërshtimi i parashikuar në pikën 2 nuk përbën ankim. Raporti dhe rekomandimet e Këshillit të Etikës kanë natyrë përgatitore dhe nuk i nënshtrohen ankimit të veçantë të brendshëm. Ligjshmëria dhe bazueshmëria e gjetjeve të raportit mund të kundërshtohen së bashku me vendimin përfundimtar që prodhon pasoja ndaj personit.
- Vendimi përfundimtar duhet të jetë i arsyetuar dhe të përcaktojë pasojën akademike ose disiplinore, organin dhe bazën ligjore të vendimmarrjes, si dhe, kur parashikohet ankim:
 - organin kompetent për shqyrtimin e tij;
 - afatin dhe mënyrën e paraqitjes;
 - efektet e ankimit mbi zbatimin e vendimit.
- Mjetet e ankimit përcaktohen sipas natyrës së vendimit:
 - ankimi ndaj vlerësimit ose procedurës së diplomimit shqyrtohet sipas Rregullores së Diplomimit;
 - ankimi ndaj një vendimi që lidhet me disertacionin, vijimin e studimeve të doktoratës ose gradën shkencore shqyrtohet sipas Rregullores së Studimeve të Doktoratës dhe legjislacionit përkatës;
 - ankimi ndaj një mase akademike ose disiplinore ndaj studentit shqyrtohet sipas Statutit dhe rregullores përkatëse të studimeve;
 - kundërshtimi ose ankimi ndaj një mase disiplinore ndaj personelit ushtrohet sipas Statutit, kontratës së punës, akteve të brendshme dhe legjislacionit të punës;

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	11 / 20

- e) ankimi ndaj një vendimi që prek një titull akademik ushtrohet sipas legjislacionit dhe aktit që rregullon organin ose institucionin që ka dhënë titullin.
- Ankimi administrativ i brendshëm ushtrohet vetëm kur parashikohet shprehimisht nga Statuti ose nga akti i posaçëm përkatës. Mungesa e një organi të brendshëm ankimi nuk mund të plotësohet duke konsideruar automatikisht si organ ankimi një organ tjetër të WBU-së.
 - Në shqyrtimin e ankimit nuk marrin pjesë personat që kanë marrë vendimin e kundërshtuar, kanë zhvilluar hetimin etik ose kanë konflikt interesi në çështje.
 - Kur i njëjti rast sjell pasoja etike, akademike dhe disiplinore, secili organ merr vendim vetëm brenda kompetencës së vet. Çdo vendim përcakton veçmas pasojën që vendos dhe mjetin përkatës të ankimit. Ankimi ndaj njërit vendim nuk zëvendëson ankimin ndaj një vendimi tjetër që prodhon pasoja juridike të ndryshme.
 - Paraqitja e kundërshtimit ose ankimit nuk pengon marrjen e masave të nevojshme për sigurimin dhe ruajtjen e provave. Efekti pezullues i ankimit përcaktohet sipas legjislacionit, Statutit dhe aktit të posaçëm që rregullon vendimin e kundërshtuar.
 - E drejta për t'iu drejtuar gjykatës kompetente ushtrohet sipas legjislacionit në fuqi.

KREU V

KLASIFIKIMI, MASAT DHE PASOJAT

Neni 23

Klasifikimi i shkeljeve

- Për studentët, shkelja klasifikohet si e lehtë, mesatare, e rëndë ose shumë e rëndë, duke vlerësuar shtrirjen, rëndësinë e përmbajtjes, qëllimshmërinë, nivelin e studimit, përsëritjen, përfitimin dhe ndikimin në vlerësim.
- Shkelje e lehtë mund të jetë citimi ose perifraximi i pasaktë, i kufizuar, i pakujdesshëm dhe pa ndikim në kontributin thelbësor. Shkelje mesatare është përvetësimi më i gjerë ose i përsëritur që cenon një pjesë të punimit, pa e zëvendësuar tërësisht kontributin personal. Shkelje e rëndë është plagjiatura e qëllimshme ose e konsiderueshme, fabrikimi, falsifikimi, blerja e punimit ose përvetësimi i një kontributi thelbësor. Shkelje shumë e rëndë është shkelja e rëndë e përsëritur ose ajo që ka përcaktuar në mënyrë vendimtare fitimin e një diplome, grade ose përfitimi të rëndësishëm.
- Për personelin akademik dhe kërkimor-shkencor, kategorizimi dhe masat harmonizohen me ligjin nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Kodin e Etikës të miratuar me VKM nr. 831/2025, Statutin e WBU, Rregulloren për Etikën në Kërkimin Shkencor dhe legjislacionin e punës. Plagjiatura e konstatuar në kërkimin shkencor trajtohet si shkelje e rëndë; përsëritja e saj si shkelje shumë e rëndë.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Mmiratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	12 / 20

Neni 24

Masat ndaj studentëve

1. Masat akademike dhe disiplinore mund të përfshijnë, sipas proporcionalitetit: korrigjimin ose përsëritjen e punimit; trajnim të detyrueshëm; uljen ose anulimin e vlerësimit të detyrës; moskalimin e lëndës ose punimit; pezullimin, vetëm në format, rastet dhe kohëzgjatjen e parashikuar në Statut dhe në rregulloren përkatëse të studimeve; dhe, për shkelje shumë të rënda, përjashtimin nga WBU-ja.
2. Masa konkrete vendoset sipas rregullores së studimeve dhe kompetencave statutoe. Përjashtimi i studentit propozohet nga Dekani, mbi bazën e raportit të Këshillit të Etikës, dhe vendoset nga Rektori, në përputhje me nenin 52, pika 2, shkronja "j", të Statutit. Masa përjashtuese përdoret vetëm për shkelje shumë të rënda dhe kur një masë më e lehtë nuk është e mjaftueshme.
3. Për doktorantët, pasojat akademike mbi disertacionin ose vijimin e programit vendosen nga organet e doktoratës, ndërsa masat disiplinore vendosen sipas Statutit dhe kësaj rregulloreje.

Neni 25

Masat ndaj personelit

1. Për shkeljet në kërkimin shkencor, Këshilli i Etikës propozon masat këshilluese, disiplinore dhe korrigjuese sipas neneve 17–21 të Rregullores për Etikën në Kërkimin Shkencor, VKM nr. 831/2025, Statutit dhe legjislacionit të punës. Masat korrigjuese mbi produktin shkencor, përfshirë korrigjimin, shënimin ose tërheqjen e publikimit, dallohen nga masat disiplinore ndaj personit.
2. Vendimi përfundimtar disiplinor merret nga Rektori për personelin akademik dhe ndihmësakademik dhe nga Administratori për personelin administrativ. Largimi nga puna nuk është pasojë automatike e raportit etik dhe vendoset nga Bordi i Administrimit, mbi bazën e raportit të Këshillit dhe propozimit të organit statutor kompetent, pas respektimit të Statutit, kontratës dhe legjislacionit të punës.
3. Përgjegjësia e udhëheqësit ose vlerësuesit lind vetëm kur provohet se ai ka shkelur me faj një detyrim konkret verifikimi, ka fshehur shkeljen ose ka vepruar në konflikt interesi; ajo nuk prezumohet vetëm nga konstatimi i mëvonshëm i plagjiaturës.

KREU VI

GRADAT SHKENCORE DHE TITUJT AKADEMIKË

Neni 26

Rivlerësimi dhe revokimi i gradës shkencore "Doktor"

1. Kur me raport përfundimtar të Këshillit të Etikës konstatohet plagjiaturë, fabrikim, falsifikim, paraqitje e të dhënave ose dokumenteve të pavërteta apo shkelje tjetër e rëndë e

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	13 / 20

integritetit që ka shërbyer për fitimin e gradës “Doktor”, raporti i plotë i përcillet Komisionit të Përherëshëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.

- Komisioni rivlerëson ndikimin e shkeljes në vlefshmërinë akademike të gradës dhe mund të caktojë ekspertë të pavarur me rol këshillimor. Ai nuk përsërit hetimin etik, por garanton të drejtën e mbajtësit të gradës për t’u njohur me materialet, për t’u dëgjuar dhe për të paraqitur prova mbi pasojën akademike. Anëtarët që kanë marrë pjesë në vendimin fillestar përjashtohen kur ekziston konflikt interesi ose dyshim i arsyeshëm për paanshmërinë.
- Kur shkelja nuk ka qenë thelbësore ose përcaktuese për dhënien e gradës, mund të vendosen publikimi i një korrigjimi ose shënimi etik, tërheqja e publikimit apo masa të tjera proporcionale. Versioni i disertacionit mbi të cilin është dhënë grada nuk zëvendësohet ose ndryshohet në mënyrë të padokumentuar.
- Kur provohet se shkelja ka qenë e rëndë dhe thelbësore ose përcaktuese, në kuptimin që grada nuk do të ishte dhënë pa të, Komisioni vendos për anulimin e gradës. Vendimi merret sipas shumicës dhe procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Studimeve të Doktoratës dhe nuk kushtëzohet nga provimi i ndikimit të gradës në përfitimet ose karrierën e mëvonshme.
- Vendimi regjistrohet në regjistrat përkatës. WBU-ja njofton ministrinë përgjegjëse për arsimin brenda 10 ditëve nga vendimi përfundimtar, sipas VKM nr. 777/2018, të ndryshuar.

Neni 27

Titujt akademikë dhe gradat e dhëna nga institucione të tjera

- Revokimi i gradës “Doktor” nuk sjell automatikisht revokimin e një titulli akademik të fituar më vonë. Dosja i përcillet organit ose institucionit që ka dhënë titullin, i cili zhvillon procedurë të veçantë për ndikimin e gradës së revokuar në vlefshmërinë e titullit.
- Kur grada ose titulli është dhënë nga një institucion tjetër, WBU-ja nuk e revokon atë, por i përcjell institucionit dhënës dhe autoritetit shtetëror kompetent vendimin dhe provat përkatëse.
- Vendimi për gradën ose titullin i nënshtrohet ankimit sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VII

KONFIDENCIALITETI, TË DHËNAT DHE TRANSPARENCA

Neni 28

Përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale

- WBU-ja, në cilësinë e kontrolluesit, përpunon të dhënat personale vetëm për parandalimin, verifikimin dhe trajtimin e shkeljeve të integritetit akademik, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, kufizimit të qëllimit, minimizimit, saktësisë, kufizimit të ruajtjes, sigurisë dhe llogaridhënies.
- Për çdo procedurë përcaktohen dhe dokumentohen baza ligjore, kategoritë e të dhënave, subjektet e përfshira, marrësit, personat e autorizuar, afati i ruajtjes dhe masat teknike e organizative të sigurisë.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	14 / 20

- Personat, të dhënat e të cilëve përpunohen, informohen për identitetin dhe kontaktet e kontrolluesit dhe të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave, qëllimin dhe bazën ligjore të përpunimit, marrësit, afatin e ruajtjes dhe mënyrën e ushtrimit të të drejtave të tyre. Informimi mund të kufizohet vetëm në rastet dhe për aq sa lejohet nga ligji.
- Të dhënat ruhen sipas një table afatesh të miratuar nga WBU-ja. Pas përfundimit të afatit, ato fshihen, anonimizohen ose arkivohen kur ruajtja e mëtejshme kërkohet nga ligji. Fshirja mund të pezullohet kur të dhënat nevojiten për një procedurë ankimi, gjyqësore ose për mbrojtjen e një të drejte.
- Akresi në dosje jepet vetëm sipas rolit dhe nevojës për njohje, regjistrohet dhe rishikohet periodikisht. Personat me akses kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin edhe pas përfundimit të funksionit të tyre.
- Kur përdoret një platformë ose ofrues i jashtëm, WBU-ja verifikon sigurinë, vendndodhjen e përpunimit, afatin e ruajtjes, të drejtat mbi punimin dhe transferimet jashtë vendit dhe lidh marrëveshjen përkatëse me përpunuesin. Punimet nuk përdoren për trajnimin e sistemeve ose për qëllime të tjera pa bazë ligjore.
- Përpara përdorimit të një teknologjie që mund të sjellë rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave, kryhet vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, kur kjo kërkohet nga ligji. Asnjë vendim me pasojë akademike ose disiplinore nuk merret vetëm mbi bazën e përpunimit automatik.

Neni 29

Konfidencialiteti dhe komunikimi

- Identiteti dhe të dhënat e raportuesit, personit të përfshirë, dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave të tjerë mbrohen gjatë gjithë procedurës dhe u bëhen të ditura vetëm personave që duhet t'i njohin për ushtrimin e funksionit ose të së drejtës së mbrojtjes.
- Njoftimet dhe dokumentet komunikohen nëpërmjet kanaleve të sigurta institucionale. Dokumentet përmbajnë vetëm të dhënat e nevojshme për qëllimin e komunikimit.
- Të dhënat mund t'u komunikohen organeve shtetërore, institucioneve financuese, botuesve ose subjekteve të tjera vetëm kur ekziston bazë ligjore dhe komunikimi është i nevojshëm e proporcional. Komunikimi dhe arsyet e tij dokumentohen.
- Konfidencialiteti nuk cenon të drejtën e personit të përfshirë për t'u njohur me pretendimet dhe provat e nevojshme për mbrojtjen e tij. Kur është e mundur, të dhënat e personave të tretë anonimizohen ose redaktohen.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	15 / 20

Neni 30

Regjistri dhe transparencë e vendimeve

1. WBU-ja mban një regjistër të brendshëm me akses të kufizuar për raportimet, procedurat, vendimet, masat, ankimet dhe ekzekutimin e tyre. Akseset dhe ndryshimet në regjistër dokumentohen.
2. Raportimi publik institucional bëhet në formë të agreguar ose të anonimizuar, në mënyrë që personat të mos identifikohen drejtpërdrejt ose tërthorazi.
3. Vendimet ose njoftimet me të dhëna identifikuese publikohen vetëm kur publikimi kërkohet shprehimisht nga ligji ose mbështetet në një bazë tjetër të vlefshme ligjore. Përpara publikimit dokumentohen domosdoshmëria, proporcionaliteti, kategoritë e të dhënave, kohëzgjatja e publikimit dhe pamundësia e arritjes së qëllimit nëpërmjet anonimizimit.
4. Kur publikimi lejohet, ai bëhet vetëm pas përfundimit të ankimit të brendshëm, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Publikimi kufizohet në informacionin minimal të nevojshëm dhe hiqet pas përfundimit të afatit të përcaktuar.
5. Kur një punim i publikuar rezulton me shkelje, WBU-ja kërkon korrigjimin, shënimin ose tërheqjen e tij sipas legjislacionit, standardeve të botimit dhe vendimit të organit kompetent.

Neni 31

Siguria dhe cenimi i të dhënave personale

1. WBU-ja zbaton masa teknike dhe organizative të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave nga akseset, ndryshimi, humbja, publikimi ose përdorimi i paautorizuar.
2. Çdo cenim i dyshuar ose i konstatuar i të dhënave personale i njoftohet menjëherë strukturës përgjegjëse dhe Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave, dokumentohet dhe trajtohet sipas procedurës së WBU-së dhe afateve ligjore.
3. Kur plotësohen kushtet ligjore, WBU-ja njofton Komisionerin dhe personat e prekur nga cenimi.

KREU VIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 32

Zbatimi në kohë dhe parashkrimi

1. Për procedurat e filluara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje zbatohen rregullat e saj procedurale nga faza në të cilën ndodhet çështja. Veprimet e kryera rregullisht mbeten të vlefshme, duke garantuar të drejtën për një proces të rregullt.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	16 / 20

- Shkelja dhe masa përkatëse vlerësohen sipas rregullave materiale në fuqi në kohën e kryerjes së saj. Kur rregulli i mëvonshëm është më i favorshëm për personin e përfshirë, zbatohet ai.
- Afatet e parashkrimit për vendosjen e masave zbatohen sipas legjislacionit dhe akteve të posaçme në fuqi. Parashkrimi i masës disiplinore nuk pengon korrigjimin e produktit shkencor ose rivlerësimin e vlefshmërisë së diplomës, gradës apo titullit akademik, kur kjo lejohet nga ligji dhe kryhet sipas procedurës përkatëse.

Neni 33

Aktet zbatuese dhe harmonizimi

- Brenda 60 ditëve nga miratimi, Rektorati përgatit ose përditëson udhëzimin teknik të kontrollit, formularët proceduralë të listuar në aneksin 2, matricën e aksesit dhe tabelën e afateve të ruajtjes. Formularët miratohen me urdhër të Rektorit, për aq sa nuk ndryshojnë të drejta, detyrime, pragje ose kompetenca. Deri në miratimin e formularëve dhe akteve zbatuese, përdoren modele të përkohshme që përmbajnë të paktën elementet minimale të përcaktuara në aneksin 2.
- Njësitë përgjegjëse i paraqesin Senatit Akademik ndryshimet e nevojshme në Rregulloren e Diplomimit, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës, Rregulloren për Etikën në Kërkimin Shkencor dhe Rregulloren e Këshillit të Etikës, veçanërisht për referimin e rasteve, ndarjen ndërmjet konstatimit etik dhe pasojës akademike, si dhe ankimin.
- Ndryshimi i sistemit antiplagjiaturë, konfigurimeve teknike ose modeleve të formularëve që nuk prek të drejta, detyrime, pragje ose kompetenca miratohet me urdhër të Rektorit dhe publikohet për përdoruesit.

Neni 34

Miratimi dhe hyrja në fuqi

- Kjo rregullore miratohet nga Senati Akademik, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Statutin e WBU-së, dhe hyn në fuqi në datën e miratimit, përveçse kur vendimi i Senatit përcakton një datë tjetër.
- Rektori merr masat për publikimin dhe zbatimin e kësaj rregulloreje. Rektori, Administratori, Këshilli i Etikës, njësitë akademike dhe organet e tjera të Universitetit e zbatojnë atë brenda kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni dhe Statuti.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	17 / 20

ANEKSI 1

DEKLARATA PËR PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Emri dhe mbiemri: _____

Programi ose njësia: _____

Titulli i punimit: _____

Deklaroj se:

- Nuk kam përdorur mjete të inteligjencës artificiale gjeneruese në përgatitjen e këtij punimi.
- Kam përdorur mjetet e mëposhtme, sipas përshkrimit vijues:
(Shënoni vetëm njërën nga alternativat)

Mjeti dhe versioni	Qëllimi i përdorimit	Pjesa e punimit ku u përdor	Verifikimi nga autori

Konfirmoj se kam verifikuar saktësinë e përmbajtjes, burimeve dhe të dhënave; se nuk kam ngarkuar të dhëna personale ose konfidenciale pa autorizim; dhe se mbaj përgjegjësi të plotë për punimin.

Data: _____ Nënshkrimi: _____

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik




	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	18 / 20

ANEKSI 2

LISTA E FORMULARËVE PROCEDURALË TË DETYRUESHËM

Nr.	Formulari	Elementet minimale
1	Formulari i raportimit të shkeljes	Raportuesi, personi/punimi, përshkrimi i pretendimit, burimi origjinal, provat dhe kërkesa për konfidencialitet.
2	Fleta e regjistrimit dhe shqyrtimit paraprak	Data e marrjes, numri i çështjes, kompetenca, baza minimale faktike, plotësimet, ruajtja e provave dhe vendimi për fillimin/mosfillimin.
3	Deklarata e konfliktit të interesit	Deklarimi nga anëtarët dhe ekspertët, shkak i përjashtimit, vendimi dhe zëvendësimi.
4	Njoftimi për fillimin e procedurës	Pretendimet, baza ligjore, provat, të drejtat, afati për përgjigje dhe të dhënat e seancës dëgjimore.
5	Procesverbali i seancës dëgjimore	Pjesëmarrësit, deklaramet, provat, kërkesat procedurale, kundërshtimet dhe nënshkrimet.
6	Fleta e administrimit të provave	Identifikimi, burimi, data e marrjes, integriteti, aksesit, kopjet dhe vendi i ruajtjes së provës.
7	Raporti i arsyetuar i Këshillit të Etikës	Faktet, provat, analiza, përgjigjet ndaj kundërshtimeve, konstatimi, klasifikimi dhe rekomandimi.
8	Modeli i vendimit përfundimtar	Organi, kompetenca, faktet, baza ligjore, arsyetimi, masa/pasoja, ekzekutimi dhe ankimi.
9	Formulari i ankimit dhe fleta e mbylljes	Vendimi i kundërshtuar, shkaqet, provat, rezultati i ankimit, ekzekutimi dhe arkivimi.
10	Formulari i deklarimit të konfidencialitetit për ekspertët	Identifikimi i ekspertit dhe i çështjes; roli dhe baza e angazhimit; deklarimi i konfliktit të interesit; përshkrimi i detyrimit të konfidencialitetit; kufizimi i përdorimit të informacionit vetëm për qëllimin e ekspertizës; ndalimi i kopjimit, publikimit ose komunikimit të

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik




RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"

Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	19 / 20

		paaautorizuar; detyrimi për ruajtjen e sigurisë, kthimin ose asgjësimin e materialeve dhe raportimin e menjëhershëm të çdo cenimi; kohëzgjatja e detyrimit; pasojat e shkeljes; data dhe nënshkrimi.
11	Regjistri i aksesit në dosje	Numri i çështjes; identiteti dhe funksioni i personit që ka aksesuar dosjen; niveli ose autorizimi i aksesit; data dhe ora e aksesit; dokumentet ose kategoritë e të dhënave të konsultuara; qëllimi i aksesit; veprimi i kryer, përfshirë konsultimin, shkarkimin, kopjimin, ndryshimin ose përcjelljen; mënyra e aksesit; personi që ka autorizuar aksesin, kur kërkohet; data e mbylljes ose kthimit të dokumentacionit; shënimet për incidente ose parregullsi.
12	Formulari i komunikimit të të dhënave të një subjekti tjetër	Identifikimi i çështjes; njësia dërguese; identiteti, statusi dhe kontaktet e marrësit; qëllimi dhe baza ligjore e komunikimit; kategoritë e të dhënave dhe dokumentet që komunikohen; kategoritë e personave të prekur; vlerësimi i domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe minimizimit; roli i marrësit si kontrollues ose përpunues; mënyra e sigurt e transmetimit; ekzistenca e transferimit jashtë vendit dhe garancitë përkatëse; kufizimet e përdorimit dhe afati i ruajtjes nga marrësi; autorizimi institucional; mendimi i Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave, kur kërkohet; data e komunikimit dhe konfirmimi i marrjes.
13	Njoftimi i privatësisë për personat e përfshirë	Identiteti dhe kontaktet e WBU-së si kontrollues; kontaktet e Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave; qëllimet dhe bazat ligjore të përpunimit; kategoritë dhe burimi i të dhënave; kategoritë e marrësve; transferimet jashtë vendit dhe garancitë përkatëse; afati ose kriteret e ruajtjes; të drejtat e subjektit dhe kufizimet e tyre ligjore; mënyra e

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik



	RREGULLORE PËR INTEGRITETIN AKADEMIK DHE PARANDALIMIN E PLAGJIATURËS NË UNIVERSITETIN "WESTERN BALKANS"				
	Kodi i Dokumentit	Hyrja në Fuqi	Nr. i Përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	WBU-REG-057-AL	03.09.2026	0	0	20 / 20

		ushtrimit të të drejtave; e drejta për t'u ankuar te Komisioneri; detyrueshmëria e dhënies së të dhënave dhe pasojat e mosdhënies, kur është e zbatueshme; përdorimi i sistemeve automatike dhe garancia se vendimi nuk merret vetëm automatikisht; data dhe versioni i njoftimit.
--	--	--

Formularët nr. 10–13 përdoren në përputhje me natyrën e çështjes dhe kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Plotësimi i tyre dokumenton konfidencialitetin, gjurmueshmërinë e aksesit, ligjshmërinë e komunikimit të të dhënave dhe përmbushjen e detyrimit për transparencë. Modelet përfundimtare miratohen sipas nenit 33 të kësaj rregulloreje, pas konsultimit me Nëpunësin për Mbrojtjen e të Dhënave.

Modelet përfundimtare të formularëve miratohen me urdhër të Rektorit. Fushat e mëposhtme janë elemente minimale dhe nuk mund të hiqen kur lidhen me garancitë procedurale ose gjurmueshmërinë e çështjes.

Njësia Hartuese	Njësia Kontrolluese	Njësia Miratuese
Zyra e Çështjeve Ligjore	Këshilli i Etikës	Senati Akademik

